

Zyra për Bashkëpunim Ndërkombëtar e Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan, Public University

shpall këtë:

Prillogaritja	20.12.2021
NUMRI I PROJEKTIT	0873193

Thirrje për aplikime për shkëmbim studentor në Universitetin "Celal Bayar" Manisa, Turqi

Universiteti "Kadri Zeka" është pjesë e projektit KA107 ICM, Erasmus +, në partneritet me Universitetin e Manisas në Turqi.

Numri i Projektit Erasmus + KA107 (ICM) 2019-1-TR01-KA107-073710

Programi Erasmus + KA107 ose Shkëmbimi afatshkurtër dhe afatgjatë i studentëve dhe ECTS (ICM) është një program i mobilitetit plotësisht i financuar që mundëson shkëmbimin e studentëve, stafit mësimdhënës dhe jo-mësimdhënës midis Universitetit Manisa Celal Bayar, Manisa, Turqi dhe Universitetit "Kadri Zeka" në Gjilan.

ICM Erasmus + mundëson shkëmbimin e studentëve nga Universiteti Universiteti "Kadri Zeka" - Gjilan për studim dhe trajnim / veprimtari të lëvizjes në fushën:

- Juridik
- Menaxhment
- Marketing
- Banka,Financa dhe Kontabilitet
- Shkenca Kompjuterike
- Edukim
- Matematikë arsimore

Të gjitha shpenzimet janë të mbuluar nga projekti:

800 Euro në muaj dhe 275 për udhëtim sipas Distance Calculator të Erasmus +

(http://ec.europa.eu/programmes/erasmus-plus/tools/distance_en.htm).

Granti i udhëtimit do të paguhet para lëvizjes.

Shënim:

- 1) Të gjithë pjesëmarrësit duhet t'i përmbahen kufizimeve të alokuara buxhetore pasi që nuk ka fonde shtesë.
- 2) Buxheti i udhëtimit llogaritet sipas llogaritësit të udhëtimit dhe edhe nëse tarifa e biletës tejkalon shumën e mbështetjes së udhëtimit, nuk mund të jepen fonde shtesë për pjesëmarrësit.

APLIKIMI dhe PËRZGJEDHJA

Dokumentet e nevojshme për aplikim:

- Certifikata e notave
 - CV (në gjuhën angleze)
 - Një letër motivimi (në gjuhën angleze)
 - Vërtetim studentit (i lëshuar nga fakulteti juaj që konfirmon nivelin tuaj dhe vitin e studimit gjatë këtij viti akademik, jo më të vjetër se 30 ditë)
 - Kopje e Pasaportës (faqja që përmban emrin tuaj, foton dhe të dhënat personale) ose Letërnjoftimit
 - Certifikata e gjuhës angleze ose turke
- Për programet e ofruara në gjuhën angleze ose turke kërkohet niveli i gjuhës minimumi B2.

Shënim:

- 1) Studenti duhet të ketë përfunduar të paktën 2 semestra në programin në të cilin janë regjistruar. Deri në ditën e fundit për aplikim, studentët të cilët kanë notë mesatare mbi 8.00 mund të aplikojnë në program.
- 2) Që studentët të marrin një grant të ICM-së, ata duhet të kalojnë të paktën një semestër (3 muaj) në universitetin pritës. Granti i mobilitetit të studentëve të ICM mbulon minimumi 90 ditë.
- 3) Studentët që do të marrin pjesë në programet e mobilitetit janë të detyruar të marrin kurse nga universiteti pritës të paktën me vlerë 30 ECTS (rreth 5 kurse).

Vlerësimi i aplikuesve:


Mesatarja e notës: 50%

Gjuhë e huaj: 50%

PROCEDURA E APLIKIMIT

- Aplikimet duhet të dorëzohen në Zyrën për Bashkëpunim Ndërkombëtar (kopje fizike) ose përmes emailit internatioanlooffice@uni-gjilan.net, mes datave 17 Dhjetor 2021 dhe 24 Dhjetor 2021. Aplikimet e vonuara nuk do të pranohen.
- Formulari i aplikimit duhet të shtypet, të nënshkruhet dhe t'i dorëzohet me dokumente të tjera të kërkuara. (<https://drive.google.com/drive/u/1/folders/1AEnbi4qKpfim0bjRp198ldhtKjjRm8yV>)
- Rezultatet e aplikimit do të shpallen në www.uni-gjilan.net

Për çdo informatë shtesë, kontaktoni zyrën për bashkëpunim ndërkombëtar në UKZ.



Me respekt,

Prof. Asoc. Dr. Dukagjin Leka
Prorëktor për Bashkëpunim Ndërkombëtar